

VENDIM
Nr. 404, datë 4.7.2018

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E BRENDSHME, TË NJË PJESE TË
PRONËS ME NUMËR RENDOR 180, ME EMËRTIMIN “POLICIA USHTARAKE
(REPARTI USHTARAK NR. 6620)”, ME VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË**

(Ndryshuar me VKM nr. 912, datë 24.12.2019)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, për një periudhë 20-vjeçare, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 24 141.4 (njëzet e katër mijë e njëqind e dyzet e një pikë katër) m², nga trualli funksional i pronës nr.180, me emërtimin “Policia Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6620)”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, sipas planrilevimit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përmbushjen e detyrave të saj funksionale.

2. Ministrisë së Brendshme i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pjesës së pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

3. Ministrisë së Brendshme i ndalohet të kryejë ndryshime infrastrukturore në objektet e dhëna në përdorim ose ndërtime të reja infrastrukturore pa miratimin paraprak të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme të nënshkruajnë aktmarrëveshjen përkatëse për dhënien në përdorim të pjesës së pronës me numër rendor 180, me emërtimin “Policia Ushtarake (reparti ushtarak nr. 6620)”, sipas pikës 1, të vendimit, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjella për secilin institucion.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

(Ndryshuar me VKM nr. 912, datë 24.12.2019)

PLAN RILEVIMI NR.2	
i pronës nr.180 Policia Ushtarake (Sipërfaqja dhe objektet që i jepen në përdorim Ministrisë së Brendshme)	
MIRATOHET KOMANDANTI I POLICISË USHTARAKE Kolonel Altin KURTI Hartoi Topograf Ramiz Haxhiu Maj 2020	IDENTIFIKIMI I PASURISË Zona Kadastrale 1605.3266. Nr.Pasurisë _____ Vol. _____ Fq _____ Indeksi i Hartes K-34-100-(27-B).K-34-100-(28-A). Shkalla 1: 2500 Adresa e pasurisë Tirane Q/F Sauk, Tirane. Pronari : Ministria e Mbrojtjes, Policia Ushtarake . DREJTORI I IGJËJ Ark. ERICA SINOIMERI SISTEMI I KOORDINATAVE (KRGJSH) N 4574565.43 E 486628.03 N 4574565.43 E 486941.40 N 4574281.62 E 486628.03 N 4574281.62 E 486941.40 Shënim: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Policisë Ushtarake nr.322/1, datë 24.01.2019. Bazuar në dokumentacionin hartografik të marrë në arkivin e IGJËJ. Sip. që kërkohet nga Bashkia e Tiranës është hedhur sipas ortofotos b/lidhur shkresës, azhronimit të kryer në terren në prani të përfaqësuesit të Policisë Ushtarake dhe të Bashkisë Tiranë. Shpjeguese Sip.e përgj. e pronës që jepet në përdorim = 24 141.4m2 Sip.e përgj. nën objekte që jepen në përdorim = 4 012.18m2 — Kufiri i pronës